

VENDIM
Nr. 747, datë 9.12.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS “DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE
KADASTRALE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi prej 652 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy milionë) lekësh, në formën e transfertës në artikullin 604, për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për projektin “Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme”.

2. Efekti financiar, prej 652 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj